



**Oifig an Choimisinéara Iarratais do Dhídeanaithe
Zyra e Komisionerit për Kërkesat e Refugjatëve**

Rregullat e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë) (S.I. Nr. 426 të vitit 2013)

**Procedurat për hetimin dhe përcaktimin e kërkesave për Mbrojtje Shtesë
Shënim Informues për Aplikuesit**

**Ky shënim është vetëm për informacion dhe udhëzim. Nuk përpiqet të japë një
interpretim ligjor të këtyre Rregullave.**

1. Hyrja.

- 1.1 Ky Shënim Informues ju jep detaje të ligjit në fuqi për hetimin dhe përcaktimin e kërkesave për mbrojtje shtesë në Shtet që përfshihen në Rregullat e Bashkimit Evropian (Mbrojtja Shtesë) 2013 (S.I. Nr. 426 të vitit 2013) - ("Rregullat 2013").
- 1.2 Rregullat 2013 janë vendosur nga Ministri për Drejtësi dhe Barazi ("Ministri") dhe kanë hyrë në fuqi më **14 nëntor 2013** ("data e fillimit").
- 1.3 Sipas Rregullave 2013, shqyrtimi i kërkesave për mbrojtje shtesë është përgjegjësia e Komisionit të Kërkesave nga Refugjatët ("Komisioneri").
- 1.4 Është e rëndësishme dhe në interesin tuaj që t'a lexoni këtë Shënim Informues për t'u siguruar që ndër të tjera të kuptoni:

- (i) Të drejtat, detyrimet dhe detyrat tuaja ndërkohë që jeni në Irlandë duke pritur një përcaktim përfundimtar të kërkesës tuaj për mbrojtje shtesë.
- (ii) Procedurat në Rregullat 2013 në pajtim me të cilat do të shqyrtohet kërkesa juaj për mbrojtje shtesë.
- (iii) Rëndësinë e zbatimit të afateve kohore dhe kërkesave të tjera të vendosura në Rregullat 2013 dhe përgjigjen e shpejtë në secilën fazë të procesit.

1.5 Nëse ju nevojitet informacion i mëtejshëm rreth Rregullave për mënyrën si zbatohen ato në një çështje individuale, duhet të merrni këshilla ligjore.

2. Qëllimi i Rregullave 2013.

2.1 Këto Rregulla vendosin një sistem për hetimin dhe përcaktimin e kërkesave të reja për mbrojtje shtesë në Shtet më ose pas datës 14 nëntor 2013.

2.2 Ato zbatohen edhe për kërkesat ekzistuese për mbrojtje shtesë drejtuar Ministrit për Drejtësi dhe Barazi (Shërbimi Irlandez për Natyralizimin dhe Imigracionin), që nuk janë përcaktuar përpara datës së fillimit të Rregullave 2013 dhe janë transferuar te Komisioneri për t'u shqyrtuar që nga kjo datë.

3. Çfarë mbulojnë Rregullat 2013?

Nëse jeni aplikues i ri për mbrojtje shtesë:

3.1 Rregullat 2013 përcaktojnë se që nga data 14 nëntor 2013, kërkesat për mbrojtje shtesë do të hetohen dhe do të përcaktohen nga Komisioneri.

3.2 Që nga kjo datë, kërkesat e reja për mbrojtje shtesë mund të bëhen te Ministri për Drejtësi dhe Barazi, por i duhen dërguar Komisionerit në Formularin e duhur të Kërkesës. Komisioneri më pas, në pajtim me Rregullat 2013 dhe pas një interviste të aplikuesit për mbrojtje shtesë, do të përgatisë një raport me shkrim në lidhje me hetimin e kërkesës. Komisioneri do të bëjë një rekomandim te Ministri për Drejtësi dhe Barazi nëse aplikuesi është një person që kualifikohet për mbrojtje shtesë.

Nëse jeni aplikues ekzistues për mbrojtje shtesë kërkesa e të cilit nuk është përcaktuar nga Ministri:

3.3 Kërkesat për mbrojtje shtesë që nuk janë përcaktuar nga Ministri për Drejtësi dhe Barazi përpara datës së fillimit të Rregullave 2013 janë transferuar te Komisioneri për t'u hetuar dhe për t'u përcaktuar. Ministri do t'i njoftojë të gjithë aplikuesit për procedurat e reja që zbatohen për të shqyrtuar kërkesat e tyre.

3.4 Këta persona nuk kanë nevojë të bëjnë kërkesë të re për mbrojtje shtesë te Komisioneri por mund të bëjnë parashtrime shtesë (shiko paragrafin 7.5 më poshtë).

4. Çfarë është mbrojtja shtesë?

4.1 Mbrojtja shtesë është mbrojtje që mund t'i jepet një personi që ka treguar arsye të konsiderueshme për të besuar se nëse kthehet në vendin e tij apo të saj të prejardhjes, do të përballet me një rrezik të vërtetë lëndimi të rëndë dhe që nuk mundet, ose për shkak të këtij rreziku, nuk dëshiron të marrë mbrojtjen e atij vendi si dhe që nuk përjashtohet nga kualifikimi për mbrojtje shtesë.

4.2 Lëndim i rëndë do të thotë -

- (a) dënim me vdekje ose ekzekutim; ose
- (b) torturë, trajtim apo dënim çnjerëzor ose degradues i një personi në vendin e tij apo të saj të prejardhjes; ose
- (c) kërcënim i rëndë ose individual ndaj jetës së një civili ose personi, për arsye të dhunës pa dallim, në një situatë konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm.

4.3 Nëse kualifikoheni për mbrojtje shtesë do të lejoheni të qëndroni në Shtet dhe do të keni disa të drejta e tagra. Këto të drejta e tagra janë përcaktuar në Rregulloren 2013.

5. Kush kualifikohet për mbrojtje shtesë?

5.1 Nëse jeni në Shtet kur e bëni kërkesën, ju kualifikoheni për mbrojtje shtesë në pajtim me Rregullat 2013 nëse:

- (a) nuk jeni shtetas i një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian,
- (b) ju është refuzuar një deklaratë si refugjat në Irlandë,
- (c) janë treguar arsye të rëndësishme për të besuar se nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës, do të përballeni me rrezik të vërtetë pasi do të vuani lëndim të rëndë dhe ju nuk mundeni, ose për shkak të këtij rreziku, nuk dëshironi të merrni mbrojtjen e atij vendi, dhe
- (d) nuk jeni përjashtuar nga kualifikimi.

5.2 Ju do të përjashtoheni nga kualifikimi për mbrojtje shtesë në pajtim me Rregullat 2013 nëse ka arsye të forta për të menduar se ju -

- (a) keni kryer një krim ndaj paqes, një krim lufte ose një krim ndaj njerëzimit, siç është përcaktuar në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të përcaktuar dispozitat në lidhje me këto krime;
- (b) keni kryer një krim të rëndë;
- (c) jeni fajtor për akte në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara siç janë përcaktuar në Parathënien dhe Nenet 1 e 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ose
- (d) përbëni rrezik për komunitetin ose sigurinë e Shtetit.

5.3 Ju do të përjashtoheni nga kualifikimi për mbrojtje shtesë nëse:

- (i) ka arsye të forta të mendohet se ju keni nxitur ose përndryshe keni marrë pjesë në kryerjen e një krimi ose të një akti që është përmendur në paragrafin 5.2 (a) deri (d),
- (ii) jeni larguar nga vendi juaj i origjinës thjesht për të t'ju shmangur sanksioneve që rezultojnë nga një krim ose krime (por që nuk përbëjnë një krim ose sjellje të renditur në paragrafin 5.2 (a) deri (d)), të kryera përpara pranimit tuaj në Shtet, ku këto krime janë të dënueshme me burg nëse do të ishin kryer në Shtet.

6. Kush mund të aplikojë për mbrojtje shtesë në Shtet?

6.1 Në zbatim të Rregullave 2013, një kërkesë për mbrojtje shtesë mund të bëhet nga një person

- (i) i cili ndodhet në Shtet dhe
- (ii) të cilit i është refuzuar një deklaratë si refugjat në Irlandë,

6.2 Nëse **Ministri** vendos të mos jua japë deklarin si refugjat, do t'ju dërgohet një njoftim me shkrim në të cilin do të thuhet se kërkesa juaj për një deklarin si refugjat është refuzuar.

6.3 Njoftimi do të përfshijë një Shënim Informues mbi mbrojtjen shtesë dhe një Formular Kërkesë. Nëse mendoni se kualifikoheni për mbrojtje shtesë, duhet ta plotësoni dhe ta ktheni formularin te Komisioneri brenda 15 ditë pune nga data e dërgimit të njoftimit.

7. **Si do të hetohet kërkesa ime për mbrojtje shtesë nga Komisioneri për Kërkesat e Refugjatëve?**

7.1 Kërkesa juaj për mbrojtje shtesë do të hetohet dhe do të vendoset nga Komisioneri në pajtim me Rregullat 2013.

7.2 Në zbatim të procedurave të reja për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje shtesë, do t'ju kërkohet të bëni një intervistë në lidhje me kërkesën tuaj. Qëllimi i intervistës është që të përcaktojë të gjitha hollësitë e kërkesës tuaj për mbrojtje shtesë.

7.3 Aplikuesi duhet të paraqitet për një intervistë në Zyrën e Komisionerit për Kërkesat e Refugjatëve në datën dhe orën e caktuar për intervistë. Kur një aplikues nuk paraqitet në intervistën e caktuar, kërkesa e tyre mund të konsiderohet si e tërhequr (shiko paragrafin 8.2).

7.4 Një aplikues mund të paraqesë parashtrime me shkrim te Komisioneri për çdo çështje që ka lidhje me hetimin dhe Komisioneri do të marrë parasysh çdo parashtrim që është bërë përpara ose gjatë intervistës në zbatim të Rregullave 2013. Parashtrimet mund të bëhen edhe nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe nga çdo person tjetër përkatës.

7.5 Nëse jeni aplikues ekzistues për mbrojtje shtesë, kërkesa e të cilit nuk është caktuar në kohën e fillimit të Rregullave 2013, duhet të lexoni dokumentin e Udhëzimeve

bashkëngjitur me letrën që ju është dërguar nga Shërbimi Irlandez për Natyralizim dhe Imigracion në lidhje me paraqitjen e parashtrimeve shtesë dhe dokumentacionit te Komisioneri.

- 7.6 Nëse është e nevojshme për të siguruar komunikimin e duhur gjatë një interviste, do të ofrohet një përkthyes(e) nga Komisioneri.

Përshkrimi i procesit të organizimeve

- 7.7 Çka më poshtë është përshkrimi i procesit të organizimeve për kërkesat e mbrojtjes shtesë.
- (i) Komisioneri do të organizojë që ju të intervistoheni në lidhje me kërkesën tuaj.
 - (ii) Pas intervistës, do të përgatitet një raport me shkrim për rezultatet e hetimit të kërkesës tuaj dhe do të bëhet një rekomandim nga Komisioneri te Ministri për Drejtësi dhe Barazi nëse ju jeni një person që kualifikoheni për mbrojtje shtesë.
 - (iii) Në rast të një rekomandimi negativ, do të keni të drejtën ta apeloni rekomandimin në Gjykatën e Apeleve për Refugjatët (Gjykata) brenda 15 ditësh nga dërgimi i njoftimit të rekomandimit negativ të Komisionerit. Gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore kur aplikuesi e kërkon këtë gjë në njoftimin e tyre të apelit; përndryshe, apeli mund të përcaktohet pa një seancë dëgjimore.
 - (iv) Bazuar në rekomandimet e Komisionerit ose vendimin e Gjykatës, Ministri në pajtim me Rregullat 2013 do t'ju japë ose jo deklarin për mbrojtje shtesë, si të shihet e arsyeshme.
- 7.8 Në rast se kërkesa juaj për mbrojtje shtesë do të refuzohet nga Ministri, do t'ju dërgohet një njoftim me shkrim në të cilin to do thuhet se:
- (a) kërkesa juaj për mbrojtje shtesë është refuzuar;
 - (b) periudha e të drejtës tuaj për të qëndruar në Shtet ka përfunduar;
 - (c) Ministri propozon të lëshohet një urdhër dëbimi në zbatim të Pjesës 3 të Ligjit të Imigracionit 1999, që ju kërkon të largoheni nga Shteti; dhe

- (d) keni një opsion për të paraqitur parashtrimet te Ministri brenda 15 ditë pune për të deklaruar përse duhet të lejoheni të qëndroni në Shtet.

8. E RËNDËSISHME: A mund ta tërheq kërkesën time për mbrojtje shtesë ose a mundet që kërkesa të konsiderohet e tërhequr?

- 8.1 Një aplikues mund ta tërheqë kërkesën e tij apo të saj për mbrojtje shtesë duke dërguar një njoftim të tërheqjes te Komisioneri.
- 8.2 Kur një aplikues nuk paraqitet për intervistën e caktuar me Komisionerin, përveç rasteve kur aplikuesi jo më vonë se 3 ditë pune nga kjo datë, i paraqet Komisionerit një shpjegim për mosparaqitjen, që për mendimin e Komisionerit është i arsyeshëm duke marrë parasysh rrethanat, kërkesa e tij apo e saj do të konsiderohet si e tërhequr në pajtim me Rregullat 2013.
- 8.3 Kur Komisioneri mendon se një aplikues:
 - (i) nuk e ka kryer detyrën e tij apo të saj për të bashkëpunuar me Komisionerin gjatë kohës së hetimit të kërkesës së tij apo të saj, ose
 - (ii) nuk e ka kryer detyrën e tij apo të saj për të paraqitur informacion përkatës për kërkesën e bërë për deklaram të mbrojtjes shtesë, ose kur Ministri njofton Komisionerin se mendon që aplikuesi e ka shkelur detyrën e tij apo të saj
 - (iii) për mos t'u larguar ose për t'u përpjekur të mos largohet nga Shteti pa pëlqimin e Ministrit, ose
 - (iv) se nuk e ka informuar Komisionerin për adresën e tij apo të saj dhe çdo ndryshim adrese sa më parë që të jetë e mundur,

Komisioneri do t'i dërgojë aplikuesit një njoftim me shkrim për ta ftuar aplikuesin të deklarojë me shkrim brenda 15 ditë pune nga dërgimi i njoftimit nëse dëshiron ta vazhdojë kërkesën dhe nëse aplikuesi nuk e paraqet një gjë të tillë brenda afatit kohor të specifikuar, kërkesa e tyre për një deklaratë të mbrojtjes shtesë do të konsiderohet si e tërhequr në pajtim me Rregullat 2013. Raporti i Komisionerit në lidhje me një kërkesë të tillë do të përshkruajë një rekomandim që aplikuesi në fjalë nuk duhet të deklarohet një person i cili kualifikohet për mbrojtje shtesë.

8.4 Në rastet kur kërkesa për mbrojtje shtesë tërhiqet ose konsiderohet e tërhequr, nuk mund të bëhet apel te Gjykata e Apeleve për Refugjatët.

9. Akses i informacionit në lidhje me procesin e mbrojtjes shtesë

9.1 Rregullat 2013 mund të shihen të plota në faqen e Komisionerit për Kërkesat e Refugjatëve në <http://www.ORAC.ie>.

9.2 Ky Shënim Informues gjendet në një numër gjuhësh në faqen e Komisionerit për Kërkesat e Refugjatëve.

10. Informacione të tjera

10.1 Ju keni të drejtën të konsultoheni me një avokat dhe mund të përdorni shërbimet e Shërbimit Ligjor për Refugjatët (Refugee Legal Service (RLS)) në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje shtesë. RLS-ja është një organizatë e pavarur krijuar për t'ju ofruar shërbim ligjor konfidencial personave që kërkojnë mbrojtje në Irlandë. RLS-ja do t'ju ofrojë këshilla ligjore dhe ndihmë në mbështetje të kërkesës tuaj. Përndryshe mund të kërkonit shërbimet e një avokati privat me shpenzimet tuaja. Keni të drejtën edhe të konsultoheni me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.

10.2 Keni leje të qëndroni në Shtet derisa të merret një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje shtesë. Ministri do t'u dërgojë aplikuesve ekzistues një letër për t'i informuar mbi këtë. Aplikuesit e rinj do ta marrin këtë letër nga Komisioneri.

10.3 Rregullat 2013 duhen lexuar për çështje të tjera procedurale që nuk janë përmendur në këtë Shënim Informues dhe për detaje mbi të drejtat e tagrat e një personi që kualifikohet për mbrojtje shtesë dhe në lidhje se për kë është në fuqi një deklaratë e mbrojtjes shtesë.

Njoftim për aplikuesit ekzistues për mbrojtje shtesë, kërkesat e të cilëve nuk janë përcaktuar nga Ministri në datën e fillimit

10.4 Nëse në kohën e fillimit të Rregullave 2013, keni bërë një kërkesë për mbrojtje shtesë dhe nuk është marrë ende një vendim për kërkesën tuaj duhet të vini re ç'ka më poshtë:

- Komisioneri do t'ju kontaktojë së shpejti në lidhje organizimin e intervistës tuaj, ndaj nuk është e nevojshme që ju të kontaktoni ORAC-un direkt apo tërthor.
- nuk rrezikoni të dëboheni ndërkohë që kërkesa juaj për mbrojtje shtesë hetohet.

14 nëntor 2013

DISA TË DHËNA KONTAKTI

Zyra e Komisionerit për Kërkesat e Refugjatëve

Timberlay House,
79-83 Lower Mount Street,
Dublin 2.

Telefoni: 01 6028000
Numri me tarifë lokale: 1890 202 418
Faqja e internetit: www.orac.ie
Emaili: oracmail@orac.ie

Gjykata e Apeleve për Refugjatët

6/7 Hanover Street East,
Dublin 2.

Telefoni: 01 4748400
Numri me tarifë lokale: 1890 201 458
Faqja e internetit: www.refappeal.ie
Emaili: info@refappeal.ie

Shërbimi Ligjor për Refugjatët

Refugee Legal Service Law Centre - Smithfield,
48/49 North Brunswick Street,
Georges Lane,
Dublin 7.

Telefoni: 01 646 9600.
Faqja e internetit: www.legalaidboard.ie
Emaili: lawcentresmithfield@legalaidboard.ie

Organizata Ndërkombëtare për Migrimin

116 Lower Baggot Street,
Dublin 2.

Telefoni falas: 1800 406 406
Telefoni: 01 6760655
Faqja e internetit: www.ireland.iom.int
Emaili: iomdublin@iom.int

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Suite 4,
Merrion House,
1-3 Lower Fitzwilliam Street, Dublin 2.

Telefoni: 01 6314510.
Faqja e internetit: www.unhcr.ie.
Emaili: iredu@unhcr.org.